


NË DEMOKRACI



KA DIVERSITET

RËNDËSIA E DEMOKRACISË

RITA (10), BLERON (10), MERISA (10), ELION (10), FJOLLA (11), SHKËLQIM (10), DIELLONA (10)



Se cilat janë të mirat e demokracisë, mund ta kuptoni pasi të lexoni artikullin tonë

Po e fillojmë këtë artikull me diçka shumë të rëndësishme për ne, e ajo është shprehja e lirë e mendimit. Sapo kemi hyrë në hapësirën e Punëtorisë së Demokracisë, edukatorët na pritën të buzëqeshura dhe vazhdimisht gjatë diskutimit të temave, ato e kërkonin mendimin tonë. Kjo na bëri që ne të ndihemi shumë mirë, pikërisht si në shtëpinë tonë. Një ndjenjë të tillë nuk e kanë të gjithë, p.sh. qytetarët të cilët jetojnë në diktaturë, sepse ata janë të privuar nga shumë të drejta. Për dallim prej tyre, ne kemi të drejta të shumta, sepse jetojmë në demokraci. Demokracia brenda vetes ngërthen shumë vlera, aplikimi i të cilave na mundëson një jetë të mirë në bashkësi. Njëra prej këtyre vlerave

është respekti i ndërsjelltë, i cili është më se i nevojshëm në një shtet multietnik, siç është Kosova. Ne nuk tregohemi injorues ndaj shokëve e shoqeve të komuniteteve të tjera jo shumicë, sepse sikurse ne, edhe ata kanë të drejta. Pra, ne jemi të barabartë pa dallim feje, moshe, race apo gjinie. Vlerë tjetër është edhe toleranca. Këtë vlerë gjithashtu ne e respektojmë, sepse ne jemi pranues ndaj bashkëqytetarëve që iu takojnë besimeve të tjera fetare.

Demokracinë në Kosovë e bëjmë ne, duke i zgjedhur përfaqësuesit tanë të cilët janë deputetët, sepse shteti ynë ka demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar.

Ky është artikulli ynë, të cilin e kemi shkruajtur me shumë dashuri, sepse demokracia na bën neve të lumtur. Një lumturi të tillë ua dëshirojmë të gjithëve.




Paqja, element bazik i demokracisë



Përfaqësues të demokracisë

VENDI I LIGJEVE

NYSRET (10), ARMEND (10), AGON (11), YLLI (10), ANISA (10), TUANA (10), MELISA (10), RINESA (10)



Tri funksionet kryesore të Kuvendit

Kuvendi është...

Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Disa nga elementet kryesore të demokracisë janë liria dhe të drejtat e barabarta. Ne si fëmijë i kemi të garantuara me ligj të drejtat tona. Disa nga të drejtat tona janë: e drejta e argëtimit, e drejta e familjes, e drejta e strehimit, e drejta e shkollimit, etj. Vendimet për këto ligje i marrin deputetët në Kuvend, të cilët na përfaqësojnë neve, popullin. Prandaj, njëri nga funksionet kryesore të këtij institucioni është funksioni legjislativ, sepse pikërisht aty miratohen ose nuk miratohen ligjet. Ligjet janë rregulla, të cilat ne duhet t'i respektojmë. Për shembull, kur jemi duke ecur në rrugë mund të hasim në një udhëkryq me semafor, dhe nëse është e ndezur ngjyra e kuqe ne duhet të ndalemi dhe të presim. Kur ndezet ngjyra e gjelbër, atëherë ne mund ta kalojmë rrugën. Kështu pra, tregohemi të përgjegjshëm, duke respektuar rregullat e komunikacionit. Mesazhi ynë për ju të dashur lexues është: t'i shfrytëzojmë këto të drejta, mirëpo duke qenë gjithmonë të respektueshëm, të përgjegjshëm për veprimet tona.



Fëmijët e demokracisë



Institucioni ligjvënës



Të drejtat tona i kemi të garantuara me ligj



Kosova, vend demokratik

VLERA E VOTËS TIME ËSHTË E MADHE

DIAR (10). ELIOS (10), ELMA (10), VERONA (10), MAGDALENA (10), ALISA (10), ERDIN (11), ERON (10)



Unë kam vlerë, sepse kam të drejtë të shpreh mendimin tim lirshëm, kam të drejtë të zgjedh vetë dhe kam të drejtë të jem qytetar aktiv

Demokracia më jep pushtet dhe vlerë, sepse është sistem aq i dashur për popullin. Por ajo që më bën të ndihem më së miri, është e drejta që e gëzon çdo qytetar për të zgjedhur lirshëm.

Kjo e drejtë është themelore për qytetarët, për arsye se përmes saj na jepet mundësia të zgjedhim dhe të shprehemi lirshëm. E zgjedhja e lirë e ka përmirësuar dukshëm jetën tonë, sepse çdo ditë ne e përdorim atë. Ne zgjedhim se çka të veshim, cilin libër ta lexojmë, me cilin shok ose shoqe ta kalojmë kohën e lirë, cilin sport ta pëlqejmë, etj.

Po ashtu, një rast kur e kemi përdorur të drejtën për të zgjedhur përmes votës është zgjedhja e kryesisë së klasës sonë. Ne të gjithë kemi shprehur mendimin se kush është më i miri ose më e mira për ta kryer këtë detyrë. Para se të vendosim se nga kush do të përbëhet kryesia e klasës, ne menduam mirë. Pse e bëmë këtë, është se ne e dijmë shumë mirë se para se të bëjmë një zgjedhje adekuate, ne duhet të tregohemi të përgjegjshëm për veprimin tonë. Kjo ndodh, sepse veprimi ynë do të ndikojë se si do të udhëhiqet klasa jonë. E pa dyshim zgjedhja e mirë ofron rezultate të mira. Por, magjia nuk qëndron vetëm tek zgjedhjet që i bëjmë në jetën e përditshme. Ajo qëndron tek fakti se ne kur ta mbërrijmë moshën 18 vjeçare, do të zgjedhim edhe për shtetin tonë. Është caktuar me ligj kjo



Shumë të lumtur që e kemi të drejtën e votës në Kosovë

moshë, për arsye se në këtë moshë mund të mendojmë më shumë dhe më mirë për personat më të duhur për ta udhëhequr Kosovën.


Prandaj, qytetarë të dashur ju e dini se vetëm për një votë mund të bëhet ndryshimi, e pse mos të bëheni ju pjesë e ndryshimit? Vota juaj e cakton të ardhmen e shtetit, andaj mos harroni ta përmbushni përgjegjësinë tuaj shtetërore.



Autorët e artikullit

AKTIVIZOHEMI PËR TË MIRËN E TË GJITHËVE

DONAT (9), ERISA (10), ERZA (10), MERISA (10), DELVINA (10), XHENIS (11), ERJON (10)



Grupi ynë me shumë dashuri, iu fton që të lexoni një shembull se si mund të jemi qytetarë aktiv

Një ditë të bukur vere, pasi ishim në pushim nga shkolla, shkuam me shokët e mi në parkun e qytetit. Në park ishte shumë bukur, kishte gjelbërim dhe ajër të pastër. Gjersa ishim duke luajtur me shokët, kemi vërejtur disa mbeturina të hedhura në park. Kjo nuk na pëlqeu aspak. E shikuam njëri-tjetrin dhe e kuptuam se të gjithë, ishim duke menduar të njëjtën gjë. Shkuam ne dyqan dhe blemë gjërat që na nevojites-

dhe vetëdijësoheshin nga mesazhi ynë. Prandaj, parku që nga ajo ditë, mbeti i pastër dhe i gjelbëruar



A e dini si quhet kjo iniciativa jonë për pastrim të parkut? Quhet punë vullnetare. Kjo punë vullnetare na bën neve qytetarë të ndershëm dhe të cilët mendojmë për të mirën e përbashkët. Andaj edhe njihemi me emrin qytetarë aktiv. Këtë mund ta bëni edhe ju qytetarë të dashur. Thjesht, merrni çdo lloj initiative që e përmirëson jetën në komunitet. Së bashku për një vend më të mirë demokratik.

hin për të mbledhur ato mbeturina në park. Filluam t'i mbledhim dhe për rreth 2 orë mbaruam punë. Ishim shumë të lumtur dhe krenar me veten. Qytetarët që kalonin aty pranë na përgëzonin për punën e bërë. Më pas, vendosëm që në një copë druri të gdhendnim një fjali me rëndësi të madhe për ne. Aty ne gdhendëm fjalinë „Ta ruajmë ambientin, sepse e ruajmë shëndetin tonë“. Që nga ajo ditë, qytetarët e lexonin



Gazetarët e lumtur demokratik



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Anton Zako Çajupi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Vushtrri